

### Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësive dhe institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi dhe përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

### Aktivitetet përgjatë muajit Shtator 2024

#### Përfundon së përgatituri dokumenti i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030

**01-30.09.2024:** Paketa e plotë strategjike e luftës kundër korrupsionit, 2024-2030, ka përfunduar së hartuari dhe mbetet në proces miratimi nga Qeveria Shqiptare. Në përmblyllje të procesit të konsultimit publik, Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030, pritet të miratohet në mbledhjen e Këshillit të Ministrave gjatë muajit në vijim, si guri i themelit që do të adresojë ndërhyrjet horizontale dhe sektoriale të luftës kundër korrupsionit në administratën publike. Institucione publike, të nivelit qendror dhe vendor, autoritete të pavarura të administratës publike, organizata të shoqërisë civile, dhoma të biznesit dhe shoqata të tyre, partnerë ndërkombëtarë dhe individë e qytetarët u bënë pjesë e konsultimit me komente, sugjerime dhe propozime konkrete. Paketa e plotë strategjike e luftës kundër korrupsionit konsiston në 3 qëllime politikash (parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim), 16 objektivë specifikë, 62 masa, 309 aktivitete dhe 26 tregues performance, vizioni i të cilës është: *Institucione shqiptare që ushtrojnë funksionet në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike duke ofruar shërbime efikase për qytetarët dhe bizneset.* Strategjia e re Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030, është dokumenti primar i politikave qeveritare kundër korrupsionit, që reflekton programe dhe iniciativa konkrete të politikës së zhvillimit kundër korrupsionit mbështetur në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim Kombëtar, Udhërrëfyesin për Shtetit e së Drejtës dhe programin e Qeverisë Shqiptare. Vlerësimi i riskut të korrupsionit në sektorë të ndjeshëm të shërbimeve publike, përfshirja e pushtetit vendor me mekanizma dhe instrumente kundër korrupsionit, hartimi dhe vënia në funksion e lobimit si instrument kundër korrupsionit dhe integriteti në sektorin privat janë risitë e këtij dokumenti që do të avancojnë Agjendën 2030 të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.




#### Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin iu bashkohet nxënësve të shkollës "Asim Vokshi" me mesazhe bashkëpunimi

**13.09.2024:** Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Adea Pirdeni, zhvilloi një bisedë të lirë shoqërore në auditorin e shkollës së mesme të gjuhëve të huaja, "Asim Vokshi", në Tiranë. "Edukimi kundër korrupsionit" rikthen ministrin Pirdeni dhe zyrtarë të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit mes nxënësve të klasës së X, duke përcjellë mesazhe direkte për integritetin, sjelljen e mirë në shoqëri, denoncimin e korrupsionit dhe veprimet etike dhe morale. Ministri Pirdeni promovoi me shumë dëshirë aktivizimin në arsim duke rritur bashkëpunimin me shkollat, dhe risjellë eksperiencën e zhvilluar në vitin e kaluar akademik 2023-2024 në shkolla të mesme të Tiranës dhe 6 rrethëve të vendit. Ministri Pirdeni foli me nxënësit dhe mësuesit e shkollës "Asim Vokshi" për kulturën e ligjshmërisë dhe qytetarisë së përgjegjshme në shkolla, çështje të mësimdhënies në lidhje me ligjin, liritë dhe të drejtat, si dhe ofroi disa ide për nxënësit në lidhje me edukimin antikorrupsion. Nxënësit e klasave të X-ta prezantuan video mesazhe me thirrje kundër korrupsionit, punime mbështetur në disiplinën e artit (piktura vizatime e foto) mbështetur në idetë e tyre si rezultat i njohurive të marra në lëndën e "Qytetarisë", njohurive të ndara nga specialistët e fushës dhe idetë risi të tyre. Projekti "Edukimi kundër korrupsionit" do të rifillojë së shpejti edhe për këtë vit akademik, 2024-2025, ku nxënësit 15-vjeçarë priten të bëhen përcjellësit më të mirë të nismave kundër korrupsionit dhe forcimit të denoncimit të rasteve korruptive në shoqëri. Kultura e ligjshmërisë dhe etika në shoqëri do të jenë promotorët e zhvillimit të shoqërisë sonë, duke garantuar zhvillimin dhe pasjen e brezave të së ardhmes të sjellshëm, me kulturë ligjore dhe kërkesë llogarie të lartë. Lufta kundër korrupsionit kërkon qytetarë të mirë dhe me njohuri, që janë motori i zhvillimit dhe garancia e integritetit në familjen evropiane.

#### Raporti "Perspektiva e Konkurrencës në Ballkanin Perëndimor 2024 (OECD Outlook, 2024) vlerëson Shqipërinë lider për politikant antikorrupsion në rajon

**04.09.2024:** Organizata OECD publikoi në Tiranë, raportin "Perspektiva e konkurrencës në Ballkanin Perëndimor 2024, Shqipëria", që mat ecurinë e politikave në sferat kryesore të ekonomive të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Raporti i vlerësimit vjen pas dy vitesh kalendarike dhe analizon politikant në 15 fusha kyçe (dimensione), dhe ndër to edhe dimensionin: Politika e antikorrupsionit. Sipas OECD, Shqipëria është vend lider në rajon për politikant antikorrupsion. Në kontekst të përgjithshëm, përbën gjetje të dhënash mbështetur në impaktin real të politikave që janë ndërmarrë e po ndërmerrin për të garantuar një standard të pakthyeshëm mirëqeverisjeje për qytetarët. Politika e antikorrupsionit, evidenton koordinimin e mirë të politikave, përmirësimet në sistemin digjital të deklarimit të pasurive dhe rolin aktiv të institucioneve ndëshkuese të korrupsionit, si përkatësisht Prokuroria e Posaçme e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar - SPAK. Raporti i OECD, adreson nevojën për ndërhyrje të reformave ligjore të avancuara dhe vlerësimi të riskut në sektorë vulnerabël dhe ku ofrohen shërbime për publikun. Raporti mbështetet në të dhënat e mbledhura nga autoritetet shqiptare, dhe organet që kanë kompetenca parandaluese dhe ndëshkuese në raste të korrupsionit.

Raporti mund të gjendet i publikuar në këtë link: [https://www.oecd-ilibrary.org/economics/western-balkans-competitiveness-outlook-2024-albania\\_541ec4e7-en](https://www.oecd-ilibrary.org/economics/western-balkans-competitiveness-outlook-2024-albania_541ec4e7-en)



#### UNODC vjen në Tiranë dhe promovon planin e punës për vitet në vijim në fushën e luftës kundër korrupsionit


**24.09.2024:** Përfaqësuesi rajonal në vendet e Ballkanit Perëndimor për UNODC, Danilo Rizzi dhe stafi i tij teknik që ndjek dhe programon projekte bashkëpunimi erdhën në Tiranë dhe zhvilluan vizita zyrtare e bashkëpunimi. Komponenti i III i programit të punës, "Lufta kundër korrupsionit" u diskutua në një takim pune në nivel teknik pranë ambienteve të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit. Znj. Fotjona Taçe, drejtor i kabinetit të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin së bashku me drejtorin e Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion, znj. Rovena Pregja, prezantuan zhvillimet më të fundit të luftës kundër korrupsionit, si pjesë e fushës së përgjegjësisë së Ministrit të Shtetit dhe shprehën dakordsinë për të adresuar bashkëpunimin për çështje të instrumenteve të integritetit, edukimit kundër korrupsionit, rishikimit të mekanizmit të UNCAC e të bashkëpunimit rajonal në fushën e ekspertizës së ndërsjellë. Platforma rajonale antikorrupsion që kulmoi me takimin e 6 vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor në Tiranë, në muajin qershor 2024, u përmend si eksperiencia e vyer e bashkëpunimit reciprok dhe për t'u replikuar edhe në raste të tjera bashkëpunimi nën koordinimin dhe me mbështetjen teknike e financiare të UNODC. Përgatitja e udhërrëfyesve për (1) ndihmën e ndërsjellë juridike në rikuperimin e aseteve dhe (2) hetimet e shpejta ndaj krimeve ekonomike dhe



financiare, këto dy produkte për autoritetet teknike shqiptare priten të vijojnë me të tjera ritme bashkëpunimi në fushën e arsimit dhe edukimit kundër korrupsionit së bashku me UNODC.


### Integriteti në sektorin privat si mekanizëm kontrolli dhe bashkëpunimi antikorrupsion

**30.09.2024:** Jahorina në Sarajevë u kthye në qendrën ku u zhvillua takimi rajonal “Integriteti i sektorit privat në Ballkanin Perëndimor”. Takimi në formatin e një konference rajonale mbledhi bashkë përfaqësues të agjencive antikorrupsion dhe të dhomave të biznesit e shoqatave, me qëllim ndarjen e eksperiencave dhe praktikave të mira se si biznesi nëpërmjet anëtarëve të tij mund të bëhet bashkëpunëtor i mirë në luftën kundër korrupsionit. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia ishin vendet që së bashku me UNODC dhe Organizatën Rajonale Antikorrupsion – RAI, promovuan rolin e sektorit privat në luftën kundër korrupsionit dhe influencat e tij. Korrupsioni nuk luftohet vetëm, fenomeni i prek të gjithë vendet dhe kërkon masa për veprim, ndaj edhe organizimi i këtij aktiviteti uli në tryezën e diskutimit profesionistë dhe teknikë të vendeve për të ndarë parashikimet e tyre dhe replikuar ndërhyrjet e njëri-tjetrit. Standardet ISO referuar integritetit në biznes dhe rruga për ndryshim u bënë teza e sesioneve për diskutim midis pjesëmarrësve. Shqipëria prezantoi parashikimet e saj të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, ku objektivi 1.9: Integriteti në sektorin privat, përbën risi në politikat e luftës kundër korrupsionit dhe vendos bazat e bashkëpunimit me sektorin. Vlerësimi i riskut të korrupsionit përfshirë sektorin privat dhe fushat ku biznesi operon kryesisht u diskutuan nga pjesëmarrësit nën mentorimin e lektorëve të lëndës “Antikorrupsioni” nga fusha akademike. Mekanizma kontrolli dhe rritja e nevojës për bashkëpunim mes agjencive antikorrupsion dhe biznesit privat u përqaftua nga të gjithë vendet pjesëmarrëse. Aktiviteti u shoqërua edhe nga një takim i posaçëm i mbajtur nga Agjencia Antikorrupsion e Bosnje&Hercegovinës me vendet e rajonit, duke propozuar kërkesën për bashkëpunim direkt dhe real mes tyre.



### Dialogu i Politikave Antikorrupsion; forum diskutimi mes vendeve të ACN/OECD

**19.09.2024:** Dialogu Rajonal i Politikave Antikorrupsion, ishte sesioni i zhvilluar në kuadër të punimeve të 29-ta të seancës plenare të organizatës ACN (Rrjeti i Agjencive Antikorrupsion) pranë OECD. Sesioni i zhvilluar shërbeu si tryezë bashkëpunimi dhe ndarje idesh dhe nismash mes vendeve anëtare të organizatës. Strategjitë Antikorrupsion dhe Planet e tyre të Veprimit, si mjete që gjenerojnë reformat antikorrupsion u diskutuan në takimin-dialog, ku vendet prezantuan rastet e tyre të ndërhyrjeve dhe të bashkëpunimeve konkrete me organizata të shoqërisë civile. Shqipëria iu bashkua takimit në formatin online dhe ndërhyri me një prezantim të përgatitur për politikën e tretë të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, për t'u miratuar së shpejti. Bashkëpunimi me OSHC-të dhe biznesin privat dhe formati i edukimit kundër korrupsionit ishin pika e referencës së prezantimit të reformës antikorrupsion të Shqipërisë për të gjithë auditorin e takimit – Dialog Rajonal i Politikave Antikorrupsion. Shqipëria ndjek dhe merr pjesë rregullisht në takimet dhe forumet e rrjetit ACN sepse vlerëson bashkëpunimin dy dhe shumë-palësh dhe ndarjen e marrjen e eksperiencave të mira të vendeve. Reforma Antikorrupsion mbetet prioriteti i vendit dhe rruga drejt Bashkimit Evropian. Ndaj edhe forma të tilla dhe pjesëmarrja aktive është standard që duhet të arrihet mirë dhe në kohën e duhur.



### Profesori i Universitetit të Harvard, Ermal Frashëri jep leksion të hapur për stafin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit

**17.09.2024:** Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit dhe Koordinatorët e Rrjetit Antikorrupsion, morën pjesë dhe përfituan nga ora e hapur e leksionit "Korrupsioni në kontekstin aktual dhe mekanizmat efektivë për parandalimin e tij", të profesorit të lëndës “Antikorrupsioni” i Universitetit të Harvardit, SHBA, Dr. Ermal Frashëri. Ora e leksionit u realizua në kuadër të projektit "Kronikat e integritetit: Rrëfimi për luftën kundër korrupsionit", një nismë shumëvjeçare që ka për synim rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmirësimin e strategjive antikorrupsion. Projekti zbatohet nga Meridian International Center dhe ka mbështetjen e plotë të Departamentit të Shtetit të SHBA-së dhe Ambasadës Amerikane në Tiranë, duke përfunduar angazhimin ndërkombëtar për rritjen e transparencës dhe ndershmërisë në vend. Gjatë orës së leksionit u analizuan faktorët kryesorë që mund të kontribuojnë në përhapjen e korrupsionit, duke përfshirë sfidat institucionale, boshllëqet ligjore dhe faktorët socialë dhe ekonomikë. Pjesëmarrësit shqyrtuan gjithashtu modele të suksesshme nga vende të ndryshme për parandalimin e korrupsionit duke u ndalur në mekanizmat më efektivë që mund të përshtaten dhe zbatohen në nivel kombëtar. Leksioni shërbeu edhe si një forum diskutimi për prodhimin e videove ndërgjegjësuese, përmes të cilave shfaqen të situata të ndryshme të korrupsionit në fusha të ndryshme si: shëndetësia, pronat, arsimi, duke synuar kështu informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut të gjerë.



### Auditimi dhe verifikimi administrativ, si pjesë e trajnimit vazhdues të stafit teknikë të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit

**24–25.09.2024:** Tirana sërish mbledhi ekspertë dhe profesionistë të fushave të kontrollit dhe inspektimit në seminarin me temë “Roli i Audituesve në luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit”. Banka Botërore promovoi ndërhyrjen dhe kujdesin e saj për të mbledhur ekspertë shqiptarë që kanë rol auditues dhe ekspertët nga institucionet e tjera që ushtrojnë funksione kontrolli dhe hetimi administrativ në institucione të administratës shtetërore, në entet publike dhe në shoqëritë tregtare me kapital shtetëror. Tre specialistë të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, me aktivitet ditor inspektimin dhe verifikimin administrativ të korrupsionit morën pjesë dhe u bënë pjesë e diskutimeve për rolin e audituesit në zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit me fondet publike, si dhe implementimi i masave parandaluese për zbutjen e riskut për mashtrim dhe korrupsion. Prezantimet gjatë sesioneve ishin interaktive, duke nxitur pjesëmarrësit të shkëmbejnë eksperiencat e tyre në trajtimin e rasteve praktike. Seminari shërbeu si një mundësi e mirë në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të institucioneve të brendshme në luftën e përbashkët kundër mashtrimit dhe korrupsionit në Shqipëri.